



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 9, Datë 06.08.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetar |
| - Z. Bashkim Sykja | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 06.08.2010, mori në shqyrtim kontratën e furnizimit me ujë te pijshëm te Ujësjiellës Kanalizime sh.a, Korçë.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes dhe degjimit te përfaqësuesve te Ujësjiellës Kanalizime sh.a, Korçë,

VËREN SE:

Kjo kontrate nuk është ne përputhje me Ligjin 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve, Pjesa V – Kushtet e padrejta te kontratave dhe përputhshmëria kontraktuale, Kreu I – Kushtet e padrejta ne kontratat me konsumatorët, pasi:

- Neni 5, paragrafi 2**, i kësaj kontrate, ndonëse është në përputhje me pikën 4, të VKM nr. 96, datë 21.2.2007, ai përbën një kusht te padrejte, pasi bie ne kundërshtim me nenin 27, pika 4, shkronja (e) të ligjit 9902, datë 17.04.2008, “*i mundësojnë tregtarit t'i japë fund kontratës për një kohëzgjatje të pacaktuar, pa njoftim të arsyeshëm, me përjashtim kur ka bazë të rëndësishme për ta bërë këtë*”, pasi në këtë paragraf nuk është parashikuar njoftimi i nevojshëm, i arsyeshëm nga ana e ofruesit te shërbimit për ndërprerjen (si psh: për mospagesë të zgjatur /të përsëritur).
- Neni 5, paragrafi 3**, i kësaj kontrate përbën një kusht te padrejte pasi bie ne kundërshtim me nenin 27, pika 4, shkronja (b) të ligjit 9902, datë 17.04.2008, “*përjashtojnë ose kufizojnë në mënyrë të papërshtatshme të drejtat ligjore të konsumatorëve përballë tregtarit ose palës tjetër, në rast të një mospërbushjeje, tërësore ose pjesore, apo përbushjeje të pamjaftueshme nga tregtari të çdo detyrimi kontraktual....*” si për afatin e ankimit prej 5 ditësh, ashtu edhe për mosparashikimin në kontratë të së drejtës së kompensimit të konsumatorëve.

3. **Neni 6, paragrafi 1**, i kësaj kontrate, për mirëmbajtjen e matësve të ujit dhe të komplet rrjetit, në rastet kur matësi i ujit dhe rrjeti janë jashtë territorit të banimit apo në ambiente të hapura dhe të aksesueshëm për të tjerët, **si dhe paragrafi 4**, i kësaj kontrate, për penalizimin e konsumatoreve në rastet e dëmtimit të matësve të ujit dhe rrjetit, megjithë pretendimin e UKKO sh.a se janë hartuar në përputhje me VKM nr. 96, datë 21.02.2007, vërejtje se dispozitat perkatëse në këtë vendim janë parashikuar vetëm për përdoruesit jofamiljarë.

Këto kushte do të konsiderohen të padrejta, mbështetur në nenin 27, pika 4, shkronja “c” dhe “d” të ligjit 9902, datë 17.04.2008, pasi “*e bëjnë një marrëveshje detyruese për konsumatorin, ndërsa furnizimi i shërbimit nga tregtari është subjekt i një kushti, realizimi i të cilit varet vetëm nga ai vetë*”, si dhe “*i kërkojnë çdo konsumatori, i cili nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij, të paguajë si kompensim një shumë të lartë jo proporcionale*”.

4. **Neni 8, paragrafi 2**, për pagesën e shpenzimeve nga vete konsumatori për furnizim me ujë të pijshëm larg nga linja kryesore, mbështetur në nenin 27, pika 4, paragrafi “b” të ligjit 9902, datë 17.04.2008 përben një kusht të padrejtë pasi “*përrjashtojnë ose kufizojnë në mënyrë të papërshtatshme të drejtat ligjore të konsumatorëve përballë tregtarit ose palës tjetër, në rast të një mospërmbushjeje, tërësore ose pjesore, apo përmbushjeje të pamjaftueshme nga tregtari të çdo detyrimi kontraktual...*”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 27, pika 4, shkronjat b, c, d dhe e, nenin 52 dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/b të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

Ujësjetësi Kanalizime sh.a Korçë, të marrë masa për ndreqjen e shkeljes, duke hequr kushtet e padrejta nga kontrata, brenda tre muajve nga dita e marrjes së vendimit.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI